

VENDIM
Nr. 9, datë 6.2.2019

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË
FINANCIARE SHITESË NGA BANKA E PARË E INVESTIMEVE, ALBANIA SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit”; nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 18, pika 8, të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, e ndryshuar; pikës 6, të shtojcës 1, të rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 36, datë 26.5.2010, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë të ndërmjetësimit në sigurime, në cilësinë e agentit në sigurime.
 2. Autorizohet guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a., pas paraqitjes të licencës së dhënë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
 4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko